



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.197/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Nenad Lazic, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës, me seli në P., kundër debitorit Objekti Afarist – Qendra Tregtare, P., – M., “.....”, me pronar A.O., nga V., me objekt kontesti borxh, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Ish Gjykata Komunale në Vushtrri, tani Degë e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Infrastrukturës, me seli në P., ndaj debitorit Objekti Afarist – Qendra Tregtare, P – M, “....”, me pronar A.O., nga V., për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej 7,676.16 €, me aktvendimin E.nr.230/2011 të datës 08.02.2012 ka ftuar kreditorin që në afat prej 7 ditësh ta bëjë pagesën në emër të taksës gjyqësore në shumë prej 50 €, ndërsa me aktvendimin E.nr.230/2011 të datës 29.02.2012 e ka konsideruar të tërhequr propozimin për përmbarim të kreditorit, pasi që i njëjti nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Ndaj aktvendimit të lartcekur kreditori ka paraqitë ankesë, ndërsa Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.2082/2012 të datës 04.11.2013 ka pranuar ankesën e kreditorit dhe ka prishë aktvendimin e Ish Gjykatës Komunale në Vushtrri E.nr. 230/2011 të datës 29.02.2012 dhe i'a ka kthyer lëndën në rivendosje Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri.

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega Vushtrri, me aktvendimin CP.nr.966/2013 të datës 26.10.2023, në pikën I të dispozitivit është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike përmbarimore të kreditorit Qeveria e Kosovës - Ministria e Infrastrukturës, me seli në P., kundër debitorit Objekti Afarist - Qendra Tregtare, P - M, "...", ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur që pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr.1990/23 të datës 28.03.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega Vushtrri, për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit Qeveria e Kosovës - Ministria e Infrastrukturës dhe debitorit Objekti Afarist - Qendra Tregtare. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr.08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, Qeveria e Kosovës - Ministria e Infrastrukturës, me seli në Prishtinë, më datë 06.07.2011 ka parashtruar propozim për ekzekutim në ish Gjykatën Komunale në Vushtrri, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitorit Objekti Afarist –Qendra Tregtare, P – M, "..."., me pronar A.O., nga V., që t'ia paguaj shumën prej 7,676.16 €. Gjykata ka lejuar propozimin për përmbarim të paraqitur nga kreditori, ndërsa me aktvendimin E.nr.230/2011 të datës 29.02.2012, e ka konsideruar të tërhequr propozimin për përmbarim të kreditorit, pasi që i njëjti nuk e ka paguar taksën gjyqësore, e pasi që kreditori ka paraqitë ankesë, Gjykata e Apelit

me aktvendimin Ac.nr.2082/2012 të datës 04.11.2013 ka pranuar ankesën e kreditorit dhe ka prishë aktvendimin e Ish Gjykatës Komunale në Vushtrri duke ia kthyer të njëjtës gjykatë lëndën në rivendosje. Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega Vushtrri ka nxjerrë aktvendimin CP.nr.966/2013 të datës 26.10.2023, me të cilin është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore për të gjykuar është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për këto arsye:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbartuesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbartimin në bazë të dokumenteve përmbartues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.”* Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, përcaktohet që: *“Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”*. Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbartimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”*.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përmbartimore është Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri, për faktin se debitori në këtë çështje përmbartimore kur është lejuar përmbartimi dhe lënda ka qenë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtrri edhe pse ka paraqitë ankesë ndaj aktvendimit E.nr.230/2011 të datës 29.02.2012, me të cilin kjo gjykatë e ka konsideruar si të tërhequr propozimin për përmbartim të kreditorit, ndërsa Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.2082/2012 të datës 04.11.2013 ka pranuar ankesën e kreditorit dhe ka prishë aktvendimin e Ish Gjykatës Komunale në Vushtrri duke ia kthyer të njëjtës gjykatë lëndën në rivendosje, ku e njëjta gjykatë pastaj është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje.

Pasi që në rastin konkret kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kaloj te përmbaruesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP-së, andaj Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit.

Pasi që për mjetet juridike të paraqitura është vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta, andaj sipas vlerësimit edhe të Gjykatës Supreme kjo çështje përmbarimore, nuk është në kompetencë të Gjykatës Komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkesave të lëndës e bazuar në dispozitat e lartcekura, gjeti se gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur sipas propozimit për përmbarim është Gjykata Themelore Mitrovicë - Dega në Vushtrri.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CN.nr.197/2024, datë 25.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Zenel Leku